



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME**  
**Nr.01-060/01-9920/23 datë:19.04.2023**



Npi – 01/152 datë: 27.04.2023

Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008); Nenin 2.1 (1.1) të Ligjit Nr.03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje; Rregulloren e (MAPL) Nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës; Statutin e Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 datë 03.09.2008; Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 27.04.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË DHE PLANIN E VEPRIMIT PËR MBROJTJE  
NGA DHUNA NË FAMILJE 2023-2025**

**I**

**Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -IV- të rregullt për vitin 2023, e mbajtur më: 27.04.2023, unanimisht miratoi Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje për periudhën 2023-2025.**

**II**

**A r s y e t i m:** Strategjia dhe Plani Veprimit për mbrojtje nga dhuna në Familje për periudhën 2023-2025, është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe procesin e diskutimit publik me qytetarë sipas vendimit të Kuvendit Npi – 01/83 datë: 15.03.2023. Kryetari ka themeluar grupin punues, prej 12 anëtarëve me vendimin Nr.02/67 më datën 21.02.2023, i cili pas shumë takimeve të punës ka nxjerrë draftin final, të cilin e ka dërguar në Kuvend për miratim.

**III**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

**IV**

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit  
Adnan Ademi